

THIRRJE PËR PROPOZIME

Ri-integrimi ekonomik për persona të riatdhesuar dhe të huaj

Udhëzues për aplikantë

**Veprimet e Komunave për Ri-integrim dhe Diasporë (Municipal Action for
Re-integration and Diaspora) - MARDI**

Nr. P220003

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve
11.11.2022, 16:00hrs (CET)

Permbajtja

1. INFORMACIONE HISTORIKU	3
2. OBJEKTIVI I THIRRJES	4
2.1. Rezultatet (autputet) e pritshme të një propozimi:	4
2.2. Aktivitetet	5
2.3 Aplikimi	5
3. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES	6
3.1. Aplikantët e kualifikuar: kush mund të aplikojë?	6
3.2. Kriteret e Përzgjedhjes – Tabela e Vlerësimit.....	6
3.3 Aktivitetet e pranueshme për t'u financuar përmes thirrjes.....	7
3.4. Shpenzimet e pranueshme.....	7
3.5. Shpenzimet jo të pranueshme	7
4. SI TË APLIKONI?	8
4.1. Formulari i aplikimit për projekt.....	8
4.2. Përmbajtja e formularit të buxhetit	8
4.3. Ku të dorëzohet aplikimi?	8
4.4. Afati për dorëzimin e aplikacioneve	9
4.6. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?	9
4.7. Sesioni informues, online nëpërmjet platformës Zoom	9
5. VLERËSIMI	9
5.1. Aplikimet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme	9
5.2. Dokumentacioni Shtesë dhe Kontraktimi	9
6. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES	10
7. LISTA E DOKUMENTEVE TË KËSAJ THIRRJEJE	10
8. KLAUZOLAT ETIKE DHE KODI I SJELLJES	10
8.1. Mungesa e konfliktit të interesit.....	10
8.2. Respektimi i të drejtave të njeriut si dhe legjislacionit mjedisor dhe standardeve bazë të punës	10
8.3. Zero tolerancë për shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual	10
8.4. Kundër korrupsionit dhe kundër ryshfetit	11
8.5. Shpenzimet e pazakonta komerciale	11
8.6. Shkeljet e detyrimeve, parregullsitë ose mashtrimi	11
9. KOSTOT E TENDERIT	11
Aneks dokumentet mund t'i gjeni ne linkun vijues: https://drive.google.com/drive/folders/1shubrPle5MFXqAXtXFFOESX2mYn6wU_U?usp=sharing	11

1. INFORMACIONE HISTORIKU

Që nga janari 2022, Caritas-i Zviceran (CACH) zbaton projektin "Veprimi i Komunave pëe Ri-integrim dhe Diasporë " (MARDI), të financuar nga S Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Qeveria e Principatës së Lihtenshtajnit dhe Caritas-i Zvicran, në bashkëfinancim me Ministrinë E Zhvillimit Rajonal.

Projekti MARDI ka objektivin e tij kryesor sa vijon:

Komunat e Kosovës perceptohen si vende të zhvillimit pozitiv socio-ekonomik, duke shfrytëzuar potencialin dhe përvojën e fortë të personave të riatdhesuar, të kthyerve, të huajve, pakicave etnike dhe diasporës.

Për këtë qëllim, projekti do të mbështesë fuqizimin e kapaciteteve të administratës vendore dhe bizneseve për të menaxhuar migrimin dhe (ri)integrimin. CACH synon të arrijë plotësisht qëllimet e projektit duke u angazhuar dhe punuar ngushtë me palët kryesore të interesit në të paktën 10 komuna të Kosovës.

Tre rezultatet kryesore të projektit MARDI janë sa vijon:

- 1. Aktorët komunalë dhe joqeveritar përmirësojnë kapacitetet dhe koordinimin e tyre për të adresuar më mirë sfidat në fushat e menaxhimit të migracionit dhe (ri)integrit;*
- 2. Kapacitetet lokale zhvillohen dhe fuqizohen për të ofruar mbështetje individuale dhe për të lehtësuar (ri)integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, refugjatëve dhe azilkërkuesve;*
- 3. Shfrytëzimi i njohurive dhe kapitalit financiar të diasporës për zhvillimin ekonomik të komunave të Kosovës;*

Kjo thirrje lidhet veçanërisht me rezultatin e dytë *Zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve lokale për të ofruar mbështetje individuale dhe për të lehtësuar (ri)integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, refugjatëve dhe azilkërkuesve.*

Shumica e personave të riatdhesuar (PR), por edhe refugjatët dhe azilkërkuesit që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare, kthehen ose mbërrijnë, përkatësisht, në Kosovë pa pasur mjete të mjaftueshme financiare. Këta njerëz duhet të mbështeten në ambiciet e tyre për t'u aftësuar dhe për të gjeneruar të ardhura, qoftë nëpërmjet formimit profesional, trajnimit në punë, punësimit ose vetëpunësimit. Përndryshe, shumë PR dhe të huaj do të dështojnë të (ri)integrohen, gjë që e bën jetën e tyre edhe më të vështirë pas kthimit ose pas largimit të pavullnetshëm nga vendet e tyre të origjinës.

Vetëm një numër i kufizuar i PV-ve, veçanërisht ata që kanë qëndruar për një periudhë më të gjatë në Evropën Perëndimore, kanë pasur mundësinë të fitojnë aftësi dhe të grumbullojnë fonde, të cilat mund t'i ndihmojnë ata të gjejnë punë ose të vetëpunësohen dhe (ri)integrohen lehtësisht në shoqërinë në të cilën janë kthyer.

Duke supozuar se shumica e PR-ve dhe të huajve që synojnë të (ri)integrohesh në shoqërinë kosovare do të kenë të njëjtat aftësi të kufizuara në aspektin e krijimit të stabilitetit ekonomik, ata kanë nevojë për mbështetje institucionale në drejtim të këshillimit, qasjes në trajnimin profesional që u mundëson atyre të bëhen pjesë e fuqisë punëtore të kualifikuar ose operojnë me sukses biznesin e tyre, mbështetje në trajnime për punë dhe punësim afatgjatë. Konsiderohet se trajnimet e mëtejshme dhe mbështetja financiare afatshkurtër do të rrisin mundësitë e tyre në tregun e punës dhe do ta bëjnë më të qëndrueshëm (ri)integrimin e tyre në shoqëri dhe veçanërisht (ri)integrimin ekonomik.

CACH, respektivisht projekti MARDI synon të lidhë grupet e synuara me programet ekzistuese të aftësimin profesional dhe t'i mbështesë nëse është e nevojshme. Përveç kësaj, projekti do të profilizojë në mënyrë aktive këta persona, të cilët më pas do të përdoren për t'i përshtatur këto profile me punëdhënësit aktivë në treg, në mënyrë që të përfshijë ata që do të jenë të kualifikuar në tregun e punës përmes masës së trajnimit në punë dhe/ose vendosjes në punë (punësimin).

2. OBJEKTIVI I THIRRJES

Objektivi kryesor i kësaj thirrjeje është:

Mbështetja për të kthyerit, refugjatët dhe azilkërkuesit që të bëhen më të aftë dhe të fuqizuar ekonomikisht përmes këshillimit për karrierë, trajnimit në punë dhe rritjes së të ardhurave.

Prandaj, qëllimi i thirrjes është të angazhojë **një (1) Organizatë Joqeveritare (OJQ) kombëtare** që do të jetë aktive në pesë rajonet e Kosovës, veçanërisht të kualifikuara për komunat e synuara të projektit:

Rajonet	Qendër	Perëndim	Jug	Lindje	Veri
Komunat	Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan	Pejë, Istog	Prizren	Ferizaj, Gjilan	Vushtrri

Kjo OJQ do të ndërmarrë aktivitete për të mbështetur personat e riatdhesuar dhe të huajt (refugjatët dhe azilkërkuesit) duke kontribuar në fuqizimin ekonomik të këtyre grupeve të cënueshme nëpërmjet këshillimit, referimit në zyrat e punësimin, referimit dhe regjistrimit në qendrat e formimit profesional dhe ofrimit të trajnimit për punë dhe punësimin.

Nga zbatimi i këtij objekti pritet të përfitojnë **200 persona** nga grupet e sipërpërmendura nga të cilët **50** do të mbështeten financiarisht, si dhe bizneset private që do të ofrojnë trajnime në punë dhe punësim nëpërmjet masave aktive të tregut të punës respektive nga të cilat do të subvencionohen drejtëpërsëdrejti.

2.1. Rezultatet (outputet) e pritshme të një propozimi:

Outputet
<i>Vlerësimi i nevojave dhe profilizimi profesional i personave të riatdhesuar, refugjatëve dhe azilkërkuesve për t'u mundësuar hyrjen në tregun e punës;</i>

Këshillim dhe mbështetje për t'u angazhuar në trajnime profesionale dhe trajnime të tjera që lehtësojnë qasjen në tregun e punës; dhe

Mbështetje në përshtatjen e profileve të grupeve të synuara me punëdhënësit e mundshëm, zbatimimi i masës më të përshtatshme të (ri)integritimit ekonomik (trajnime profesionale trajnimi në vendin e punës dhe punësimi) për përfituesin dhe monitorimi i zbatimit të aktivitetit.

2.2. Aktivitetet

AKTIVITETET
<i>Draftimi i planit të vlerësimit dhe vlerësimi i nevojave përsa i përket (ri)integritimit ekonomik të të paktën 200 PR, refugjatëve dhe azilkërkuesve,</i>
<i>Referimi i rasteve të vlerësuara për masa të tjera (ri)integrimi (p.sh. mbështetje psiko-sociale, ligjore, mjekësore) nëse është e nevojshme,</i>
<i>Profilizimi profesional për të paktën 200 persona të grupeve të synuara për të rritur mundësinë e tyre për (ri)integrim ekonomik.</i>
<i>Bazuar në profilet e krijuara, këshillimin dhe referimin e të paktën 200 PR, refugjatëve dhe azilkërkuesve për t'u regjistruar në zyrat e punësimit dhe qendrat e formimit profesional për të marrë shërbime për (ri)integrimin ekonomik në secilën komunë të synuar.</i>
<i>Këshillimi i RP-ve, refugjatëve dhe azilkërkuesve në mënyrë të drejtpërdrejtë për të fituar qasje në programet e trajnimit për aftësitë e jetës, edukimin financiar, këshillimin për borxhet, aftësitë e ndërmarrësisë dhe trajnimin profesional përmes 30 sesioneve të organizuara.</i>
<i>Në koordinim të plotë me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), përkatësisht zyrat komunale të punësimit, hulumtimi i tregut të punës dhe identifikimi i punëdhënësve potencial.</i>
<i>Në koordinim me zyrat e punësimit, përputhja e profileve të personave të vlerësuar me punëdhënësit e mundshëm për të mundësuar gjenerimin e të ardhurave afatgjatë.</i>
<i>Koordinim i plotë me punëdhënësit për përfshirjen e grupeve të synuara në masat përkatëse aktive të tregut të punës.</i>
<i>Përgatitja e mënyrës së personalizuar të angazhimit të përfituesit në bizneset e identifikuar.</i>
<i>Lehtësimi i angazhimit kontraktual ndërmjet përfituesit dhe punëdhënësit.</i>
<i>Ekzekutimi i pagesave mujore për përfituesit e angazhuar në aftësi profesionale, trajnime për punë dhe/ose punësim.</i>

2.3 Aplikimi

Organizatave mund të aplikojnë për shumën totale prej 125,100.00- EUR.

Shuma totale duhet të përfshijë:

- Mbështetja e drejtpërdrejtë për përfituesit e (ri)integritimit ekonomik është rezervuar për shumën 90,000.00 EUR, ku në total pesëdhjetë (50) persona pritet të mbështeten financiarisht (50p x EUR 1,800 = EUR 90,000);
- Këshillimi për aftësitë jetësore, edukimi financiar, trajnimi mbi ndërmarrësinë, referimi i përfituesve në QAP dhe zyrat e punësimit si dhe kostoja e administrimit do të financohen nga shuma maksimale e mbetur. (35,100 EUR).

CACH pret një kontribut nga aplikanti ose një palë e tretë prej të paktën 10%, ndërsa kontributi me vlerë më e lartë do të vlerësohet pozitivisht.

3. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

3.1. Aplikantët e kualifikuar: kush mund të aplikojë?

- ✓ Organizatat joqeveritare të regjistruara në përputhje me Ligjin nr. 06/l-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare;
- ✓ OJQ-të duhet të kenë kapacitete financiare dhe organizative për të zbatuar projektin (të paraqesin raportet e auditimit institucional);
- ✓ Qarkullim vjetor prej të paktën 50,000 euro për vitin 2021 (në rastin e konsorciumeve, vetëm aplikanti kryesor duhet të plotësojë këtë kriter);
- ✓ Konsorciumet e OJQ-ve mund të aplikojnë ku aplikanti kryesor duhet të zbatojë 70% të projektit dhe buxhetit të tij;
- ✓ Të kenë një historik dhe aktivitetet t'i kenë të fokusuara sipas mandatit/statutit të tyre në zhvillim të bizneseve, aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave, puna me grupet e cënueshme, promovimi dhe mbështetja e punësimit;
- ✓ Të ketë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- ✓ Të regjistruar për të paktën 5 vjet përpara datës së publikimit;
- ✓ Të paktën pesë (5) referenca projektsh, ku tre (3) prej tyre janë projekte që kanë kontribuar në fushat e mëposhtme: zhvillimi i bizneseve, punësueshmëria, migrimi, integrimi social ose të krahasueshme;
- ✓ OJQ-të të cilat nuk janë në proces falimentimi, likuidimi apo në procedura të mbledhjes së borxheve;
- ✓ 3 vite përvojë paraprake në bashkëpunimin me organizata ndërkombëtare/OJQ ndërkombëtare;
- ✓ Kapacitet të demonstruar për menaxhimin e aktiviteteve të propozuara;

3.2. Kriteret e Përzgjedhjes – Tabela e Vlerësimit

Granti do t'i jepet tenderuesit përgjegjës, propozimi i të cilit ndjek udhëzimet e thirrjes, bazuar në aplikimin e kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

#	TABELA E KRITEREVE TË VLERËSIMIT	WEIGHTING %
1	Metodologjia e sugjeruar për zbatim	20
2	Përvoja e OJQ-ve (portofoli si dëshmi – shih 3.1)	20
3	Kapaciteti për të menaxhuar ndërhyrjen	20
4	- Aktivitetet e riintegritimit) dhe përvojë e dëshmuar e punës me palër e interesit vendore dhe sektorin e biznesit; - Ekspertë, lehtësues dhe staf mbështetës të kualifikuar për të mbuluar fushat e mëposhtme: profilizim, këshillim, lehtësim në aftësi profesionale, trajnime në punë dhe punësim; - OJQ-të që kanë kapacitete kërkimore për të kryer analiza dhe raportime, si dhe për të vlerësuar rezultatet e procesit.	20
5	Oferta financiare/Buxheti (përfshirë bashkëfinancimin/kontributin vetanak)	20
PESHA E PËRGJITHSHME		100%

3.3 Aktivitetet e pranueshme për t'u financuar përmes thirrjes

- ✓ Periudha e pranueshme e projektit të propozuar nga: 1 janar 2023 – 30 dhjetor 2023; Projekti duhet të zgjasë së paku 12 muaj brenda kësaj periudhe kohore.
- ✓ Aktivitete do të implementohen për persona të riatdhesuar, refugjatët dhe azil kërkuesit në pesë rajonet e Kosovës (**Qendër** - Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan, **Perëndim** – Pejë, Istog, **Jug** – Prizren, **Lindje** – Ferizaj, Gjilan, **Veri** - Vushtrri)
- ✓ Lista dhe llojet kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes kësaj thirrjeje janë renditur në pikën **2.2.** të kësaj thirrjeje.

3.4. Shpenzimet e pranueshme

Sipas përkufizimit të kostove direkte të pranueshme, këto janë shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve specifike të projektit të propozuar, si p.sh.:

- ✓ Vlerësimi i nevojave dhe profilizimi i personave të riatdhesuar, azil kërkuesëve dhe refugjatëve;
- ✓ Këshillimi dhe kur është e nevojshme shërbime trajnimi për grupet e synuara për të fituar shkathtësi jetësore, njohuri financiare, aftësi të ndërmarrësisë dhe të tjera;
- ✓ Lehtësimi dhe mbështetja e drejtpërdrejtë financiare për Aftësime Profesionale, Trajnime në Punë dhe Punësim për 50 persona të grupeve të synuara për (ri)integrimin e tyre ekonomik;
- ✓ Tarifat e shërbimit, duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale;
- ✓ Shpenzimet e komunikimit (telefonit, internetit, etj.) të lidhura drejtpërdrejt me projektin;
- ✓ Shpenzimet e transportit (kur është e nevojshme duke specifikuar numrin e njerëzve, destinacionin, shpeshtësinë dhe qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit publik);
- ✓ Shpenzimet tjera që lidhen me zbatimin e aktiviteteve të projektit të lidhura me (ri)integrimin ekonomik;

3.5. Shpenzimet jo të pranueshme

Shpenzimet jo të pranueshme përfshijnë:

- ✓ Shpenzimet e përgjithshme administrative / indirekte;
- ✓ Investimet kapitale ose kreditë investive, fondet e garancisë;
- ✓ Shpenzimet e blerjes së punimeve të ndërtimit;
- ✓ Blerja e automjeteve;
- ✓ Pijet alkoolike;
- ✓ Materialet shkollore dhe sende të tjera të prodhuara nga plastika;
- ✓ Shpenzimet e interesit të borxhit;
- ✓ Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- ✓ Pagesat dhe bonuset për punonjësit;
- ✓ Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifatat për transfertat financiare dhe tarifatat e tjera të një natyre thjesht financiare;
- ✓ Shpenzimet që tashmë janë financuar nga burime të tjera publike ose shpenzime në periudhën e projektit të financuara nga burime të tjera;
- ✓ Kostot e shkaktuara para dhënies së projektit ose pas përfundimit të kontratës;
- ✓ Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);

- ✓ Donacionet e bamirësisë si shpenzime;
- ✓ Kreditë për organizata ose individë të tjerë;
- ✓ Shpenzimet e zakonshme operative (mirëmbajtje dhe të ngjashme, kosto të tjera operative);
- ✓ Shpenzimet tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

4. SI TË APLIKONI?

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjithë formularët e aplikimit dhe shtojcat e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si më poshtë:

1. Formulari i Aplikimit për Projekt - **Annex 1;**
2. Formulari i Propozim Buxhetit - **Annex 2 (EUR);**
3. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
4. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
5. Pasqyrat financiare vjetore nga ATK për 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021);
6. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës lidhur me statusin e borxhit publik e vlefshme në ditën e aplikimit, e cila vërteton se aplikanti nuk ka borxhe aktuale tatimore të papaguara apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK-në;
7. Të paktën tre (3) projekte referuese, mundësisht në fushat e mëposhtme: mjedisi, ndryshimet klimatike, qeverisja lokale ose aktivizmi rinor;
8. Para nënshkrimit të marrëveshjes, OJQ-ja fituese duhet të paraqesë dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim për vepra penale;
9. Aplikimi mund të dorëzohet në gjuhët zyrtare në Kosovë apo edhe në angleze.

4.1. Formulari i aplikimit për projekt

Plotësimi i formularit të aplikimit për projekt është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ai përmban informacione për aplikantin si dhe të dhëna për përmbajtjen e projektit për të cilin synohet financimi. Në rast se formularit të dorëzuar i mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të shqyrtohet. Formulari duhet të plotësohet në mënyrë elektronike. Nëse formulari plotësohet me dorë, ai nuk do të merret parasysh. Nëse formulari përshkruar përmban defekte si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

4.2. Përmbajtja e formularit të buxhetit

Formulari i propozim-buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm (shih Shtojcën 2). Nëse formulari i buxhetit nuk plotësohet tërësisht, ose nuk dorëzohet në shabllonin e kërkuar, aplikimi nuk do të merret parasysh. Nëse formulari plotësohet me dorë, ai nuk do të merret parasysh.

Gjatë pregaditjes së buxhetit, Trajnime për Aftësi Profesionale, trajnimet në punë dhe punësimi (EUR 1,800 për person për 6 muaj) duhet të dedikohen për së paku 50 përfitues të përzgjedhur, prandaj nuk mund të përdoren për të mbuluar aktivitete të tjera të projektit.

4.3. Ku të dorëzohet aplikimi?

OJQ-të e interesuara me kualifikime përkatëse dhe përvojë kërkohen të dorëzojnë një kopje elektronike të aplikimit të tyre, duke përfshirë formularët e detyrueshëm (të cilët duhet të

nënshkruhen nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosen me vulën zyrtare të organizatës) dhe dokumentacionin e kërkuar të skanuar (në mënyrë ideale në një format të lartë PDF), me temën REF: “(Ri)integrimi ekonomik për Persona të Riatdhesuar dhe të Huaj” në: kosovo@caritas.ch dhe në CC: lsekiraqa@caritas.ch.

4.4. Deadline for submitting applications

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **11 nëntor 2022 ora 16:00 (CET)**.

4.6. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha kërkesat në lidhje me Thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar një kërkesë me shkrim në adresën e mëposhtme elektronike: kosovo@caritas.ch, në CC: lsekiraqa@caritas.ch, jo më vonë se **7 ditë para** skadimit të thirrjes.

4.7. Sesioni informues, online nëpërmjet platformës Zoom

Ju lutemi vini re se sesioni informues do të mbahet online nëpërmjet platformës Zoom; Tema: Thirrje për propozime (Ri)integrimi ekonomik për persona të riatdhesuar dhe të huaj
Koha: tetor 28, 2022 02:00 PM Belgrade, Bratislava, Ljubljana

Join Zoom Meeting

<https://us04web.zoom.us/j/4365375123?pwd=S0xaZXJMNIBPajJZZ2lkUUYkpsQT09>

Meeting ID: 436 537 5123

Passcode: ji8sRg

5. VLERËSIMI

5.1. Aplikimet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme

- ✓ Komiteti i Vlerësimit do të përgatisë një listë të të gjithë aplikantëve që kanë plotësuar kriteret e kualifikimit për të vlerësuar përmbajtjen e aplikimeve të tyre, si dhe një listë të aplikantëve që nuk i kanë plotësuar kriteret e kualifikimit të konkurrimit;
- ✓ CACH do të njoftojë me shkrim vetëm aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë për refuzimin ose përzgjedhjen e aplikimit të tyre;
- ✓ Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes dhe ofertës financiare të aplikimeve nga Komiteti i Vlerësimit. Çdo aplikim i pranuar do të vlerësohet në bazë të kriterëve të renditura në pikën **3.2** të kësaj thirrjeje;

5.2. Dokumentacioni Shtesë dhe Kontraktimi

- ✓ Për të shmangur kostot shtesë të panevojshme gjatë aplikimit, CACH do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë që, bazuar në procesin e vlerësimit, kanë hyrë në listën e përkohshme të aplikimeve të përzgjedhura për financim.
- ✓ Nëse aplikanti nuk dorëzon dokumentacionin shtesë të kërkuar brenda afatit të caktuar, aplikimi do të refuzohet.
- ✓ Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të aplikimeve të përzgjedhura për financim.

6. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes:

1. Data e lansimit të Thirrjes 21 tetor 2022;
2. Data për sesionin informues 28 tetor 2022
3. Afati për të dërguar pyetje lidhur me thirrjen është 3 nëntor 2022
4. Afati i fundit për aplikim është 11 nëntor 2022
5. Data e parashikuar për njoftimin e aplikimeve fituese në lidhje me vendimin e dhënies dhe njoftimin e aplikantëve është 21 nëntor 2022
6. Afati i fundit për parashtrimin e ankesave është 30 nëntor 2022

CACH rezervon të drejtën të përditësojë kalendarin indikativ.

7. LISTA E DOKUMENTEVE TË KËSAJ THIRRJEJE

1. Formulari i Aplikimit – Shtojca 1;
2. Formulari i Propozim Buxhetit - Shtojca 2 (ju lutemi përpiloni buxhetin bazuar në kostot e pranueshme të përmendura më sipër);

8. KLAUZOLAT ETIKE DHE KODI I SJELLJES

8.1. Mungesa e konfliktit të interesit

Aplikanti nuk duhet të ndikohet nga ndonjë konflikt interesi dhe nuk duhet të ketë marrëdhënie ekuivalente në këtë drejtim me aplikantët e tjerë ose palët e përfshira. Çdo përpjekje e një aplikanti për të marrë informacion konfidencial, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar në Komisionin e vlerësimit ose autoritetin kontraktor gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të aplikimeve do të çojë në refuzimin e aplikimit të tij dhe mund të rezultojë në dënime administrative.

8.2. Respektimi i të drejtave të njeriut si dhe legjislacionit mjedisor dhe standardeve bazë të punës

Aplikanti dhe stafi i tij duhet të respektojnë të drejtat e njeriut. Në veçanti dhe në përputhje me aktin në fuqi, aplikantët të cilëve u janë dhënë kontrata duhet të jenë në përputhje me legjislacionin mjedisor, duke përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, dhe me standardet thelbësore të punës të zbatueshme dhe siç përcaktohet në konventat përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (siç janë konventat për lirinë e asociimit dhe negociatat kolektive; eliminimi i punës me dhunë dhe të detyruar; diskriminimi me bazë gjinore në lidhje me punën; çrënjosja e punës së fëmijëve).

8.3. Zero tolerancë për shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual

Caritas-i Zvicëran zbaton një politikë të 'zero tolerancës' në lidhje me të gjitha sjelljet e pahijshme që kanë ndikim në besueshmërinë profesionale të aplikantit. Ndalohen abuzimi fizik ose ndëshkimi, ose kërcënimet për abuzim fizik, abuzimi seksual ose shfrytëzimi, ngacmimi dhe abuzimi verbal, si dhe forma të tjera të frikësimit.

8.4. Kundër korrupsionit dhe kundër ryshfetit

Aplikanti duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret dhe kodet në fuqi në lidhje me anti-ryshfetin dhe luftimin e korrupsionit. Caritas Zviceran rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë financimin e projektit nëse zbulohen praktika korruptive të çfarëdo lloji në çdo fazë të procesit të dhënies së kontratës ose gjatë ekzekutimit të një kontrate dhe nëse autoriteti kontraktor nuk merr të gjitha masat e duhura për të korrigjuar situatën. Për qëllimet e kësaj dispozite, "praktikat korruptive" janë ofrimi i një ryshfeti, dhurate, shpërblimi ose komisioni për ndonjë person si një nxitje ose shpërblim për kryerjen ose përbajtjen nga çdo veprim që lidhet me dhënien e një kontrate ose ekzekutimin e një kontrate të lidhur tashmë me autoritetin kontraktues.

8.5. Shpenzimet e pazakonta komerciale

Aplikimet do të refuzohen ose kontratat do të ndërpriten nëse del se dhënia ose ekzekutimi i një kontrate ka shkaktuar shpenzime të pazakonta komerciale. Shpenzime të tilla të pazakonta komerciale janë komisionet që nuk përmenden në kontratën kryesore ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur në mënyrë të rregullt që i referohet kontratës kryesore, komisionet që nuk paguhen në këmbim të ndonjë shërbimi faktik dhe legjitim, komisionet e transferuara në një parajsë tatimore, komisionet e paguara për një përfitues që nuk është identifikuar qartë, ose komisione të paguara për një kompani që duket se është një kompani fiktive. Përfituesit që konstatohen se kanë paguar shpenzime të pazakonta komerciale për projektet e financuara nga Caritas-i Zviceran i nënshtrohen, në varësi të seriozitetit të fakteve të vëzhguara, ndërprerjes së kontratave të tyre.

8.6. Shkeljet e detyrimeve, parregullsitë ose mashtrimi

Caritas-i Zviceran rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë procedurën, kur procedura e dhënies dëshmon se ka qenë subjekt i shkeljes thelbësore të detyrimeve, parregullsive ose mashtrimit. Nëse pas dhënies së kontratës zbulohen shkelje thelbësore të detyrimeve, parregullsi ose mashtrim, autoriteti kontraktues mund të përbahet nga lidhja e kontratës.

9. KOSTOT E TENDERIT

Caritas-i Zviceran në Kosovë nuk do të mbulojë kostot e tenderit dhe rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë tenderuesit, ose të anulojë ose shtyjë të gjithë procesin e tenderimit përpara nënshkrimit të ndonjë marrëveshjeje.

Aneks dokumentet mund t'i gjeni ne linkun vijues:

https://drive.google.com/drive/folders/1shubrPle5MFXqAXtXFFOESX2mYn6wU_U?usp=sharing